

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektiligj “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr.1071, datë 23.12.2015 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	09.1.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	15.2.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	20.3.2019
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MSHMS- Nr. 02
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Eneida Capo eneida.capo@shendetesia.gov.al +355696996606 Nexhila Kodra nexhila.kodra@shendetesia.gov.al ; +355694490328 Thanas Bello thanas.bello@shendetesia.gov.al ; +355674974778
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Problemet në shqyrtim lidhur me skemën e ndihmës ekonomike kanë të bëjnë me mosmbledhjen në kohë të këshillave bashkiakë të cilët kanë penalizuar vazhdimisht qytetarët në mosmarrjen në kohë të përfitimit të ndihmës ekonomike, i cili është i vetmi burim të ardhurash për këto familje në nevojë. Problematikë tjetër që evitohet në skemën aktuale ka të bëjë me shmangien nga punësimi të përfituesve të ndihmës ekonomike të cilët janë në moshë aktive pune dhe mospërfshirjen e tyre në programe formimi dhe aftësimi për punë. Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të adresuar sfidat lidhur me rritjen e efikasitetit të skemës së ndihmës ekonomike, duke e kthyer këtë skemë nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të riintegritit dhe alternativitetit të tyre me skemat e punësimit. Tjetër problem në shqyrtim është procesi aktual i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili aktualisht është i gjatë e i komplikuar, i ndryshëm për aftësi të kufizuara të ndryshme, i komplikuar për kërkuesin e përfitimeve dhe jo eficient, i vështirë për t’u menaxhuar nga pikëpamja administrative, dhe i kushtueshëm. Sistemi aktual bazohet tërësisht në kritere mjekësore dhe nuk merr në konsideratë aftësitë e individit për të realizuar aktivitetet e jetës së përditëshme. Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të realizuar shtrirjen progresive të vlerësimit bio-psiko-social, i cili bazohet në standardet ndërkombëtare të OBSH-së dhe Konventën për të drejtat e PAK të ratifikuar nga shteti shqiptar dhe që aktualisht po aplikohet vetëm në dy njësi administrative të bashkisë Tiranë. Problem në shqyrtim i Qeverisë ka qenë edhe nevoja e një politike sociale për mbështetjen e lindjeve. Bazuar në të dhënat statistikore mbi lindjet të INSTAT rezulton se numri i tyre ka rënë. Arsytet e rënies së këtij numri	

janë të shumta, ndër të cilat: (i) emigracioni i popullsisë në moshë fertile; (ii) rritja e moshës mesatare të martesës si te femrat ashtu dhe te meshkujt; dhe (iii) përdorimi i metodave të planifikimit familjar. Kjo çështje adresohet përmes garantimit të mbështetjes financiare për familjet me foshnja të porsalindura e cila nxit njëkohësisht lindshmërinë .

Adresimi i këtyre problematikave bëhet ndër të tjera duke forcuar instrumentat ligjorë dhe mekanizmat institucionalë. Ndërhyrja e qeverisë në këtë aspekt është e rëndësishme pasi garantohet mbrojtje sociale për të gjitha kategoritë në nevojë, por jo vetëm, si edhe vendosja e njerëzve në qendër të sistemit të mbrojtjes sociale, sikurse parashikohet në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2015-2020.

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

1. Brenda vitit 2020 përmes krijimit të mundësive për punësim do të rritet përfshirja e përfituesve të ndihmës ekonomike në politikat aktive të tregut të punës me 5%.

2. Brenda vitit 2020 përmes reformimit të sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimit sipas “Modelit Social” do të ulen me 10% rastet abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar, në zonat ku do të zbatohet ky model vlerësimi.

3. Brenda vitit 2020 për çdo fëmijë të porsalindur, do të jepet në formën e një ÇEK-u të emetuar në emër të nënës, masa e ndihmës së menjëhershme financiare.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 - status quo-ja: implikon vazhdimin e përdorimit të ligjit aktual. Përveç mungesës së avantazheve të dukshme, ky opsion paraqet disavantazhin e persistimit të problematikave që hasen sot në skemën e mbrojtjes sociale.

Opsioni 1 (i preferuar) hartimi i një ligji tërësisht të ri për asistencën sociale. Konsiderohet relevant për situatën aktuale pasi mundëson adresimin e të gjitha problematikave dhe nevojave për ndërhyrje si më poshtë vijon:

- vonesa në gjenerimin e vendimit për përfitimin nga skema e ndihmës ekonomike për shkak të mosmbledhjes në kohë të këshillave bashkiak, duke penalizuar qytetarët në nevojë të mos marrin në kohë pagesën e ndihmës ekonomike.

- vështirësitë në procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar siç janë mosfunksionimi i komisioneve mjekësore, vlerësimi bazohet vetëm në kriteret mjekësore, mbi ngarkesë pune ku në një ditë mund të vlerësohen mbi 100 dosje.

Nevojat për ndërhyrjet kanë të bëjnë me anashkalimin e vendimmarrjes së këshillit bashkiak për dhënien e ndihmës ekonomike që jepet përmes sistemit të pikëzimit, pasi kjo e drejtë i është atribuar me ligj Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, dhe deri më tani vendimmarrja e këshillit bashkiak kufizohej vetëm në propozimin e familjeve aplikuese, ndërkohë që vendimi me familjet përfituese nga sistemi i pikëzimit nuk përfshin të gjitha familjet aplikuese. dhe e anashkalimit të vendimmarrjes së e Këshillit Bashkiak për pagesat e aftësisë së kufizuar, për shkak se kjo e drejtë i jepet individit në bazë të vlerësimit të komisionit të posaçëm për vlerësimin e aftësisë së kufizuar.

Gjithashtu adresohet nevoja që ka të bëjë me me riintegrimin social të familjeve dhe individëve në nevojë.

Opsioni 2 ose ndryshimet në ligjin ekzistues. Konsiderohet irelevant pasi ndërhyrjet e nevojshme prekin parimet bazë të ligjit dhe shumicën e neneve kryesore të ligjit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni 1 përmbush objektivat politikë të Qeverisë lidhur me zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara.

Për skemën e ndihmës ekonomike, ky opsion do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në skemë dhe transformimit të programit të ndihmës ekonomike në skemë aktive riintegrimi, nëpërmjet krijimit të paketës për krijimin e mundësive për punësim. Transformimit të programit të Ndihmës Ekonomike në skemë aktive nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, duke rritur përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës. . Ndihma Ekonomike është një skemë e përkohshme, e cila ofrohet për më të varfërit e të varfërve dhe programi riintegruar pritet të mbështesë punësimin e përfituesve të ndihmës ekonomike pranë komuniteteve të tyre, bashkive apo në projekte të qeverisjes qendrore. Popullsia e shenjëstruar është ajo e përfituesve të ndihmës ekonomike.

Për skemën e aftësisë së kufizuar ky opsion do të ndikojë në reformimin e sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimit sipas “Modeli Social”; duke ulur rastet e abuzivitetit të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar; rritjen e transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet përdorimit të regjistrat elektronik; dhe krijimin e një sistemi shërbimesh integruar që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në Cash.

Projektligji nuk ka ndikim financiar shtesë në buxhetin e shtetit pasi përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2019, përkatësisht nga fondet e parashikuara në Programin Buxhetor “Përkujdesi Social”.

Efektet financiarë që rrjedh nga secili opsion është i njëjtë pasi lidhet me zerin 606 të Programit Buxhetor “Përkujdesi Social” Transferta për buxhetet familjare dhe individët që konkretisht janë pagesat e ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe bonusit të bebeve. Fondi për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar është i përcaktuar nga tavanet e miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për programin buxhetor afatmesëm 2019-2021.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Metoda e përdorur për zgjedhjen e opsionit të preferuar është nëpërmjet analizës kosto-efektivitet.

Nga kjo analizë ka rezultuar që me të njëjtin buxhet opsioni 1 ofron pagesa më të larta për grupet e prekura nga ky opsion, pagesa të larta që nënkuptojnë përfitime më të larta për buxhetet e familjeve dhe individëve në nevojë. Rishikimi i programeve të përfitimit të pagesave, sipas këtij opsioni dhe analizës së kryer, rezulton në rritje të masës së përfitimit për individ. Targetimi më i mirë, vlerësimi i saktë dhe i bazuar në standartet dhe kriteret e miratuara nga OBSH për personat me aftësi të kufizuar dhe rritje e masës së përfitimit do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së jetesës së kategorive në nevojë.

Gjithashtu përmes këtij opsioni të përzgjedhur arrihen objektivat e politikës dhe parashikohet një impakt pozitiv në fushën e mbrojtjes sociale duke sjellë ndikim në rritjen e eficiencës dhe barazisë në skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, targetimin më të mirë dhe mbulimin më të gjerë të familjeve dhe individëve në nevojë, rritjen e numrit të lindjeve dhe mbështetjen e familjeve me foshnja të porsalindura, administrim, menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të mbrojtjes sociale, shmangien e abuzivitetit dhe menaxhimin më të mirë të informacionit nëpërmjet SMI-ve.

Propozimi nuk ka efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit për vitin aktual pasi përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2019, përkatësisht nga fondet e parashikuara në Programin Buxhetor “Përkujdesi Social”. Për vitet në vazhdim sipas tavaneve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 parashikohet rritje e fondit të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, përkatësisht me 1,7% në vitin 2020 dhe 6% në vitin 2021.

Rishikimi i programeve të përfitimit të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar lidhet me targetimin më të mirë të familjeve të varfëra dhe administrim më të mirë të fondeve. Parashikohet shmangie e rasteve të abuzivitetit. Me skemën e vjetër janë mbuluar rreth 80,000 mijë familje në skemën e ndihmës ekonomike dhe rreth 170,000 persona me aftësi të kufizuar, duke marrë pagesa të ulëta. Ndihma ekonomike jepej në masë

të pjesshme duke patur familje përfituese që merrnin 1000 lekë në muaj dhe pagesa mesatare në 3500 lekë në muaj. Personat me aftësi të kufizuar merrnin të njëjtën pagesë pavarësisht nivelit të sëmundshmërisë.

Me skemat e reja targetohen më mirë familjet në nevojë, përjashtohen rastet abuzive, dhe me heqjen e tyre nga skema duke qene se kane perfutuar abuzivisht, rritet dhe masa e pagesës mesatare për individ.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Sipas programit afatmesëm buxhetor 2019-2020 (faza III) të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Programin buxhetor “Përkujdesi Social” 10430, për zërin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” janë parashikuar fondet si më poshtë:

Viti 1	Viti 2	Viti 3
22,500,000,000	22,900,000,000	24,000,000,000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përmbyllur detyrimin ligjor për ta konsultuar këtë projektligj përmes konsultimeve të hapura në mjediset e MSHMS në datë 09 Janar 2019, ku nga pjesëmarrësit u sugjeruan dhe u reflektuan komente që kanë të bëjnë me:

- Titullin e projektligjit duke zëvendësuar termin “Mbrojtje Sociale” me “Asistencë sociale”, pasi mbrojtja sociale përfshin një gamë më të gjërë shërbimesh sociale.
- Zëvendësimin e përkufizimit të aftësisë së kufizuar sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.
- Rishikimin e parimeve të ligjit dhe shpjegimi i tyre sipas konventave.
- Përkufizimin e përfitimeve në pagesa dhe natyrë dhe shtjellimin e disa termave të përdorur në projektligj.
- Shtimin e disa detyrave pushtetit vendor të cilat kanë të bëjnë me informimin e publikut, bashkërendimin e informacionit me njësi të tjera të vetqeverisjes vendore dhe referimin e përfituesve edhe në shërbime të tjera përmes bashkëpunimit me struktura të tjera që ofrojnë shërbime sociale, shëndetësore, të arsimit, punësimit, strehimit, etj.
- Rishikimin e afateve të ankimimit, duke i dhënë më shumë kohë qytetarit për të ushtruar këtë të drejtë.
- Saktësimin e disa termave të përdorur dhe riformulim frazash/fjalishë duke përdorur një gjuhë më të drejtpërdrejtë e të kuptueshme.
- Përcaktimin e afateve në dispozitat kalimtare dhe dispozitën për aktet nënligjore.
- Përcaktimin e dispozitave në ligjet referuese, apo përdorimin e përkufizimit të plotë të marrë nga ligji referues.
- Përfshirjen e familjeve me më shumë se dy deklarime të rreme në rastet që duhet të penalizohen me përjashtim nga skema e ndihmës ekonomike, me argumentin se kërkojnë të përfitojnë padrejtësisht përmes mashtrimit në mënyrë të përsëritur.

Nuk reflektohen komentet për arsyet e mëposhtme:

- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në llogaritjen e masës së ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes. Nuk reflektohet ky koment për shkak se nga i njëjti program buxhetor “Përkujdesi Social” përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar dhe se ky sugjerim nuk shoqërohet me

asnjë argument bindës.

- Komente të cilat kanë të bëjnë me çështje të cilat rregullohen me akte nënligjore, të tilla si përcaktimi i masave të pagesave për arsimimin e personave me aftësi të kufizuara, të cilat synohen që në vijim të transferohen gradualisht në legjislacionin e arsimit në kuadër të reformës, me qëllim që të merret në natyrë përmes bursave apo formave të tjera të mbështetjes.
- Komenti për parashikimin e vetëm një forme të vlerësimit të aftësisë së kufizuar pasi reforma e vlerësimit bio-psiko-social do të shtrihet në mënyrë progresive dhe skema ekzistuese e vlerësimit nuk mund të mbetet e parregulluar me ligj, pasi do të shkaktonte *Gap* ligjor.
- Heqja e kufizimit që Këshilli Bashkiak ka për të marrë vendim për trajtimin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, vetëm për familjet aplikuese në sistem për përfitimin e ndihmës ekonomike, pasi këto raste mund të trajtohen nga fondet e vetë Bashkive.
- Çështja e garantimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore për ndihmësit personalë, pasi është çështje do të rregullohet me akte nënligjore.
- Komenti se projektligji ka mungesë totale të një neni, perkufizimesh të ndërhyrjeve dhe diagnostikimit në moshë të herëshme, për shkak se parandalimi dhe ndërhyrja e hershme janë procese që i paraprijnë vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe rregullohen me ligje sektoriale në fushën e shëndetësisë dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- Komenti për heqjen e kufizimit "...pas daljes nga institucionet...", për viktimat e trafikimit, për shkak se këto përfitime garantohen në bazë të VKM nr. 114, datë 31.01.2007 të ndryshuar, gjatë qëndrimit në institucion.
- Komenti për lenien evazive dhe pa një përcaktim të kushteve të përfitimit të ndihmës personal pasi të gjitha këto grupe të aftësisë së kufizuar të cilat kanë të drejtë për kujdestarë përfshihen në pikat 2 dhe 3 të nenit 7.
- Komenti për harmonizimin e nenit 16 me VKM nr. 431/2016, pasi komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar janë përcaktuar në nenin 7 të ligjit.
- Përcaktimi i procedurave, për shkak se do të përcaktohen me akte nënligjore.
- Komenti se qindra familje rome dhe egjiptiane janë përjashtuar nga sistemi për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve, mungesës së buxhetit dhe prioritarizimit në sistem. Sistemi nuk prioritetizon dhe nuk është subjektiv në përzgjedhje. Nuk është i argumentuar pretendimi për pamjaftueshmëri të fondeve.
- Pretendimi i përjashtimit nga skema e ndihmës ekonomike të rasteve të shkeljeve të rënda të etikës në punë dhe zgjidhjes së kontratës nga punëdhënsi në mënyrë të menjëhershme. Kur kontrata zgjidhet nga punëdhënësi familja nuk përjashtohet nga NE
- Lidhur me komentin se ligji duhet të parashikojë transparencë më të madhe për sistemin e pikëzimit dhe llogaritjes së pikeve, sqarojmë se transparenca e formulës bëhet me VKM.
- Nuk reflektohen komente për ndryshimin e renditjes së neneve, por do të kihen në konsideratë gjatë reflektimit të mendimeve të Ministrisë së Drejtësisë e cila është kompetente për tu shprehur mbi teknikën legjislative dhe nëse do të ketë përpunime do të përfshihen në një fazë tjetër.
- Lidhur me komentin se në ligj nuk dalin rregullime të përfitimeve në natyrë, sqarojmë se këto rregullime gjenden në nenin 11, pika 2 e tij.
- Komenti për të përdorur perkufizimin e INSTAT mbi "Njësinë ekonomike familjare" për termin "familje" nuk qëndron, pasi nuk përpunohet.
- Shtimi i personave të verbër në kategoritë që përjashtohen nga përfitimi nuk reflektohet, pasi për aq kohë sa nuk përmenden në nenin e kategorive përfituese, do të thotë që nuk përfitojnë nga ky ligj pasi trajtohen me ligj të vecantë.
- Komenti se mbështetja me pagesa për nxitjen e vaksinimit të fëmijëve është e tepërt, nuk pranohet, për arsye se kjo është një formë nxitjeje e vaksinimit të fëmijëve sipas kalendarit të detyrueshëm të vaksinimit.
- Komenti për periudhën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar krahas pagës, do të rregullohet dhe detajohet me akte nënligjore.
- Komenti se për moshat e rritura, deklarimi i remitancave cënon parimin e dinjitetit/personalitetit

njerëzor, nuk qëndron sepse sipas Bankës së Shqipërisë remitancat janë pjesë përbërëse në identitetin e llogaritjes së të ardhurave të disponueshme.

- Lidhur me komentin se cila strukturë e bashkisë ekzekuton pagesat, mendojmë që është e tepërt për tu specifikuar sektori përkatës, për sa kohë që përmendet institucioni (Bashkia).
- Lidhur me komentin se ka kontradiktë mes neneve 21 dhe 22 të ligjit, nuk qëndron.
- Lidhur me komentin se ankimimi për personat me aftësi të kufizuar nuk garantohej nga dispozita e ankimimit, sqarojmë se procedura e ankimimit për vendimin e marrë nga KMCAP e nivelit të parë në KMCAP Epror realizohet në bazë të legjislacionit për sigurimet shoqërore dhe VKM-së përkatëse për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Epror.
- Komenti për ndryshimin e pikës 2/d të nenit 14 si masë e ashpër dhe penalizuese për kategori që nuk janë në gjendje të njohin dhe respektojnë afatet ligjore dhe sugjerimi se në këtë rast duhet rritur roli proaktiv i administratorit shoqëror për të marrë kontakt fizik dhe nxituar përfituesit për deklarimin e ndryshimeve të situatës së tyre ekonomike, nuk reflektohet për shkak se, familjet përfituese përveç të drejtave kanë edhe detyrime për të siguruar qëndrueshmërinë në skemën e NE-së.

Projektligji u shpall për konsultim edhe në faqen elektronike zyrtare të MSHMS <http://shendetesia.gov.al/6-konsultime-mbi-projektligje/>

Projektligji është konsultuar në 61 bashkitë e vendit dhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisë Qendore dhe Vetëqeverisjes vendore.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Shërbimi Social Shtetëror është një institucion buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, i cili ka si mision zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shërbimi Social Shtetëror është i organizuar në nivel qendror dhe rajonal (12 Drejtori Rajonale).

Pranë njësite të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e kësaj politike, janë ngritur dhe funksionojnë Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në nivel bashkie dhe zyrat e ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar në çdo njësi administrative..

Realizimi i objektivave do të mundësohet përmes rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, ndërgjegjësimit publik dhe rritjes së kapaciteteve të strukturave ligj zbatuese.

Monitorimi do të realizohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes Regjistrat Kombëtar Elektronik dhe përmes ushtrimit të kontrolleve në terren.

Kontrolli i ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuara bëhet nga struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal, sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 566, datë 29.9.2018.

Çdo fazë e procesit monitorues e kontrollues është e digjitalizuar, duke nisur që nga planifikimi e deri tek raportet e kontrollit dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dala nga kontrollet e ushtruara.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Fillimi i zbatimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar ka filluar që me miratimin e ligjit 9355/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. Që nga ky vit deri më tani ky ligj është ndryshuar shtatë

herë, ku si qëllim ka qenë përmirësimi i këtyre skemave. Me ndryshimet e shumta të këtij legjislacioni dhe në kuadër të reformave të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare, lindi nevoja për hartimin e një ligji të ri.

Skema e vjetër e Ndhmës Ekonomike ishte një skemë pasive e cila nuk shënjestronte familjet më të varfëra, pasi përzgjedhja e tyre për t'u bërë pjesë e kësaj skeme lihej në vendimmarrjen nga keshillat bashkiake sipas nje liste manuale aplikimesh nga qytetarët. Ekzistonin kritere përjashtuese, dokumentacion i rënduar për t'u plotësuar në 8 zyra të shtetit, nuk kishte një regjistër me të dhëna të digjitalizuara dhe ekzistonte një ndihmë e plotë dhe e pjesshme e cila rëndonte skemën e Ndhmës Ekonomike.

Hershëm, në vitin 2010-2012, Banka Botërore citon në Dokumentin e tij Politik të Asistencës Sociale se. Ndhma Ekonomike mbulon vetëm 7,3 % të të gjithë popullsisë, ndërsa mbulimi i familjeve të varfëra me Ndhmë Ekonomike, nga viti 2010 ishte ulur me 14%.

Për arsytet e mësipërme, Banka Botërore i sygjeron Qeverisë Shqiptare të atëhershme të ndërmarrë këtë reformë duke përdorur një Formulë Pikëzimi me variabla e koeficientë, të cilët janë relevantë për shënjestrimin e varfërisë dhe për gjetjen e më të varfërve mes të varfërve. Në vitin 2012 nënshkruhet edhe Marrëveshja në Parlament dhe ratifikohet me ligjin nr. 84/2012 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale. Fillon pilotimi i skemës së re në tre rajonet Tiranë, Durrës dhe Elbasan, ku përfshihej rreth 40% e popullsisë dhe kishte një kategorizim në zona malore, urbane dhe rurale. Formula u bë nga ekspertët e Bankës Botërore, të cilët bënë projektimin e saj, përpunimin e variablave dhe koeficientëve, pas një testimi në terren të të gjitha të dhënave të kësaj formule.

Pas pilotimit, në 1 Janar 2018 u realizua shtrirja e skemës së dixhitalizuar të ndihmës ekonomike në 9 qarqe të tjera të vendit.

Gjatë shtrirjes së skemës së re të Ndhmës Ekonomike gjatë gjithë vitit 2018 u paraqitën disa problematika të cilat tashmë janë reflektuar në ligj. Ndryshimet ligjore që paraqesim do të rrisin eficiencën dhe barazinë në skemën, targetimin më të mirë dhe mbulimin më të gjerë të familjeve dhe individëve në nevojë, do të lehtësojnë procedurat duke eliminuar tërësisht hallkën e këshillave bashkiake, duke rritur masën e ndihmës ekonomike nëpërmjet heqjes së tavanit të saj, duke përmirësuar përfshirjen e të rinjve në marrjen e bursave, duke përmirësuar skemën nëpërmjet gjetjes së mekanizmave për punësim të qëndrueshëm për anëtarët e skemës së Ndhmës Ekonomike.

Skema aktuale e vlerësimit të aftësisë së kufizuar bazohet në kriteret mjeko-ligjore. Këto kritere përbëhen nga dy dokumenta të cilët konsiderohen orientues dhe përshkruajnë rreth 387 diagnoza mjekësore, kryesisht nga këndvështrimi i prekjes së aftësisë për punë. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar ka si pikësynim përcaktimin e të drejtës për të marrë përfitimet në pagesë apo përfitime të tjera të posaçme. Studimi i përfitimeve të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale ka nxjerrë në pah se: (a) ka trajtim të privilegjuar e të pajustifikuar të disa kategorive të aftësisë së kufizuar, të cilët përfitojnë si nga sistemi i sigurimeve shoqërore ashtu edhe nga sistemi i mbrojtjes sociale; (b) nuk ka përshkallëzim të pagesave sipas nevojave të shkaktuara nga efekti i aftësisë së kufizuar në kryerjen e veprimtarive bazë të jetës; (c) nuk ka përcaktime ligjore për moshën maksimale të komisionimit, gjë që bën që shumë nga sëmundjet e pleqërisë të trajtohen me pagesa të aftësisë së kufizuar, dhe (d) në kundërshtim me përvojën ndërkombëtare, nuk ka diferencime për pagesat për fëmijë dhe të rritur.

Përfitimet që administrohen nga sistemi i mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara bazohen në një sërë dokumentash ligjore, tre prej të cilëve janë statute të veçanta. Kjo shpërndarje e përfitimeve sipas statuteve, ka krijuar një përshkallëzim të pagesave që nuk përlligjet plotësisht e në të gjitha rastet me shkallën e nevojave funksionale të individëve në këto kategori, krahasuar me kategoritë e tjera, ndërkohë që ka krijuar një pabarazi shoqërore në shpërndarjen e përfitimeve.

Në lidhje me skemën e vlerësimit të Aftësisë së kufizuar është ndërmarrë nisma për rishikimin e saj dhe është testuar në terren në dy njësi vendore sistemi i ri i bazuar në kritere të reja vlerësimi për aftësinë e kufizuar sipas standardeve të OBSH-së. Kjo nëpërmjet Marrëveshjes me Bankën Botërore e cituar më sipër, por dhe me një dokument shtesë të miratuar në nëntor 2018. Testimi i kësaj skeme të re nxori në pah dobishmërinë e vlerësimit të ri, bazuar në një Regjistër Elektronik Kombëtar, në pagesa më të larta, në lehtësim dokumentacioni dhe në një vlerësim të nevojave të individit me aftësi të kufizuara, nëpërmjet një Njësie të re vlerësimi të dedikuar, pranë Shërbimit Social Shtetëror. Efikasiteti i kësaj skeme pas testimit, na orientoi për ndryshime ligjore duke parashikuar shtrirjen e skemës së re të vlerësimit, në vitin e parë në Tiranë dhe brenda vitit 2021 në Durrës dhe Elbasan, si rajone pilote.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Përfitimi për ndihmë ekonomike kalon përmes një procesi aplikimi pranë njësisë administrative nën juridiksionin e të cilit është banor aplikuesi; verifikimit të të dhënave të bëra përmes vetëdeklarimit dhe vendimmarrjes përfundimtare që realizohet në nivel rajonal. Ky proces konsiston në tre “vendimmarrje” në tre nivele të ndryshme, (i) projektvendimi i hartuar nga njësia administrative, (ii) vendimi për propozim i marrë nga Këshilli Bashkiak dhe (iii) vendimi përfundimtar nga DRSHTSH pasi kjo e fundit ka kryer edhe verifikimin e të dhënave me institucionet e tjera, proces ky i cili duhet të finalizohet brenda muajit të aplikimit nga ana e qytetarit.

- *Identifikoni shkaqet e problemit.*

Lidhur me këtë proces, problemi kryesor është mosmbledhja në kohë e disa këshillave bashkiak dhe për pasojë janë tejkaluar afatet e vendimmarrjes nga ana e drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror, duke penalizuar qytetarët në nevojë, të cilët nuk e kanë marrë në kohë pagesën e ndihmës ekonomike.

Për sa i përket sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, procesi aktual i vlerësimit është i gjatë e i komplikuar. Ai është i ndryshëm për aftësi të kufizuara të ndryshme, i komplikuar për kërkuesin e përfitimeve dhe jo eficient, i vështirë për t’u menaxhuar nga pikëpamja administrative, dhe i kushtueshëm.

Problematikat e hasura në këtë proces kanë të bëjnë me: (a) mungesë njëtrajtshmërie në funksionimin e komisioneve mjekësore, për sa i përket praktikave të vlerësimit dhe njohjes e përcaktimit të aftësisë së kufizuar; (b) raste flagrante të konfliktit të interesit, kur të njëjtët mjekë mund të referojnë individin në Komision duke qenë mjekë specialistë, dhe më tej bëjnë përcaktimin për aftësinë e kufizuar të tij/saj si anëtar Komisioni; (c) mbingarkesë pune, ku në një ditë mund të vlerësohen 150-200 dosje; (d) mungesë trajnimit për të bërë interpretimin e kriterëve dhe kërkesave; (e) mungesë personeli, veçanërisht të mjekëve të specializuar; (f) mjedise të papërshtatshme e të papërshtatura pune e pritjeje; dhe prezencë e presionit psikologjik nga të dy palët (mjekët dhe aplikuesit) për përfitime të padrejta. Kjo problematikë ka krijuar kushte për favorizimin e abuzimit

- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*

Shkaku kryesor i këtyre problemeve janë këshillat bashkiak, të cilët nuk mbledhen në kohë. Konkretisht për muajin Tetor 2018, 44 Këshilla Bashkiakë dhe për muajin Nëntor 2018, 36 Këshilla Bashkiakë janë mbledhur jashtë afatit të përcaktuar me ligj për miratimin e familjeve që propozohen për trajtim me ndihmë ekonomike, duke vonuar procesin e verifikimit dhe të vendimmarrjes për 48,499 familje për muajin Tetor dhe 45,875 familje për muajin Nëntor.

- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*

Grupi i prekur nga dy problemet kryesore të lartpërmendura janë të gjithë familjet/individët në nevojë, të cilët aplikojnë për përfitim nga pagesa e ndihmës ekonomike dhe të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemet do të shmangen përmes projektligjit të ri i cili parashikon shmangien e projektvendimit dhe vendimit për propozim të miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe marrjen e vendimit nga niveli rajonal përmes dhe bazuar në listën e aplikuesve të përcjellë nga struktura e shërbimeve sociale në bashki. Po ashtu, për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, propozohet zbatimi i modelit bio-psiko-social duke parashikuar shtrirje progresive të këtij sistemi.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Nisur nga ankesat e vazhdueshme të qytetarëve për mosmarrjen në kohë të pagesave si edhe nga vetë kërkesat e njëjësive të vetqeverisjes vendore, të cilat kanë kërkuar shmangien e kësaj procedure të konsideruar nga ana e tyre si krejt formale, u ndërmor nisma e hartimit të këtij projektligji.

Përmes kësaj ndërhyrjeje do të mundësohet që procesi i aplikimit, verifikimit dhe vendimmarrjes mbi përfituesit e ndihmës ekonomike të realizohet brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me qëllim që familjet dhe individët në nevojë të marrin në kohë këtë përfitim, i cili konsiderohet si vetmi burim të ardhurash për familjen.

Kjo do të jetë një ndërhyrje afatgjatë e cila do t'i shërbejë mirëfunksionimit të skemës së ndihmës ekonomike.

Kjo ndërhyrje është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, Kapitulli 3 “Shërbimet Publike”, seksioni 3.3 “Shëndetësia dhe Kujdesi Social” dhe hartohet jashtë programit analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Skema e Ndihmës Ekonomike është skema kryesore e Shqipërisë për asistencën sociale e shënjestrar mbi varfërinë. Ajo financohet nga qeveria qendrore, e cila kanalizon grantet bllokndihmë në pushtetin vendor, i cili kryen shpërndarjen e pagesave tek përfituesit, aplikimet e reja dhe verifikimet social ekonomike. Ministria harton në nivel kombëtar legjislacionin, përcakton dokumentacionin, procedurat për përfitimin e skemës. Shërbimi Social është struktura zbatuese e cila ndjek implementimin e legjislacionit dhe strukturat rajonale të cilat pas verifikimit të të dhënave kryejnë vendimmarrjen për familjet dhe individët në nevojë të cilët aplikojnë përmes pushtetit vendor për përfitim të ndihmës ekonomike.

Tashmë, i gjithë ky proces realizohet nëpërmjet përdorimit të Regjistrat Elektronik Kombëtar në rang vendi.

Skema e re po implementohet që nga Janari 2018 në nivel kombëtar. Kjo skemë promovon parimin ndërsektorial të transparencës. Familjet pa të ardhura apo me të ardhura të pakta dhe individët në nevojë janë përfituesit që mbështeten nga kjo skemë. Në veçanti, kjo skemë targeton dhe adreson resurset në mënyrë efektive tek më të varfrit dhe më të rrezikuarit në shoqëri, duke përfshirë në programin e ndihmës ekonomike të varfrit që skema e vjetër i kishte përjashtuar më parë për shkak të kriterëve. Me heqjen e kriterëve përjashtues u bë e mundur që për herë të parë të aplikonin për ndihmë ekonomike familje të cilat më parë nuk mund të aplikonin e jo më të përfitonin ndihmë ekonomike. Me skemën e re të ndihmës ekonomike u hoq masa e pjesshme e ndihmës ekonomike. Veç ndihmës ekonomike, familjet në nevojë përfitojnë lehtësira dhe subvencione të tjera si në shërbime shëndetësore, arsimim, strehim, pagesa të energjisë elektrike, etj.

Një tjetër risi e kësaj skeme është dyfishimi i fondit të akorduar bashkive për të trajtuar me ndihmë ekonomike familjet të cilat bashkia vlerëson se janë në nevojë edhe pse nuk kanë dalë përfituese nga sistemi elektronik. Kështu, Këshilli Bashkiak do të ketë në kompetencë miratimin e kriterëve dhe përfituesve nga fondi 6%.

Për sa i përket reformimit të sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, theksojmë se kjo reformë është e domosdoshme për disa arsye si: (a) reflektimi i praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor në vlerësim bio-psiko-social, për të reflektuar konceptin e ri të aftësisë së kufizuar si një ndërveprim të dëmtimeve funksionale të shkaktuara nga një sëmundje me faktorë psikologjikë e socialë; (b) rritja e efikasitetit të vlerësimit, duke krijuar mekanizmat administrativë që reduktojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit, rrisin besueshmërinë dhe ulin koston e vlerësimit dhe (c) përmirësimi i shërbimit për qytetarët. Për më tepër, ky reformim është një domosdoshmëri për të unifikuar qasjen e vlerësimit me parimet e shprehura në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, si edhe me nenin përkatës të Ligjit nr.93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (Kapitulli III, neni 10).

Kjo nismë është ndërmarrë së fundmi nga Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale me konsulencën e Projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale në Shqipëri”, të financuar nga huaja IBRD Loan 8141-AL e Bankës Botërore. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar prek dy sisteme, atë të sigurimeve shoqërore dhe atë të mbrojtjes sociale. Duke pasur parasysh ndryshimet thelbësore ndërmjet dy sistemeve, projekti i Bankës Botërore është fokusuar në sistemin e mbrojtjes sociale. Vlerësimi bio-psiko-social është pilotuar në dy njësi administrative të Bashkisë Tiranë, përkatësisht Njësia Administrative nr. 6 dhe Njësia Administrative nr. 7 dhe aktualisht kjo reformë synon të shtrihet në mënyrë progresive në të gjithë vendin.

Gjithashtu, për zonat në të cilat nuk po aplikohet ky sistem, qeveria shqiptare duke patur në fokus qytetarin dhe lehtësimin e tij që nga viti 2018 ka marrë masa dhe ka realizuar disa përmirësime në sistemin aktual lidhur me: (i) lehtësimin dhe reduktimin e dokumentacionit të tepërt që duhet të përgatisë individit që kërkon të vlerësohet / rivlerësohet për aftësinë e kufizuar; (ii) shmangien e burokracive, vonesave të panevojshme dhe vajtje - ardhjeve të individëve nga një institucion në tjetrin për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit; (iii) institucionet publike janë ato që kryejnë jo vetëm procesin e diagnostikimit dhe të referimit të rasteve për vlerësim por edhe

përgjegjëse për përcjelljen e dokumentacionit nga një institucion në tjetrin, gjë të cilën deri më parë e ka bërë qytetari; (iv) individët me aftësi të kufizuara dhe të verbërit paraqiten për diagnostikim dhe ekzaminim vetëm në institucionet shëndetësore dhe vlerësimi kryhet në bazë të dokumentacionit mjekësor, duke shmangur paraqitjen e tij fizike.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me programin e ndihmës ekonomike, kanë të bëjnë me: (i) administrimin dhe funksionimin e një skeme të përmirësuar të ndihmës ekonomike; (ii) thjeshtimin e procedurave të panevojshme për shkak të riorganizimit të skemës, të cilat janë bërë pengesë për mospërfitimin në kohë të ndihmës ekonomike; (iii) nxitjen e punësimit dhe përfshirjen e personave në moshë aktive pune përfitues të ndihmës ekonomike në programet aktive të punësimit dhe formimit profesional; (vi) nxitjen e punësimit të anëtarëve në moshë aktive pune përmes ofertave të përshtatshme të punës të ofruara nga zyrat e punës; (v) forcimin e masave shtrënguese në rastet e refuzimit apo largimit nga puna, me synimin për të shmangur sigurimin e të ardhurave në mënyrë alternative (informale); (vi) mbështetjen familjeve me fëmijë studentë dhe mospenalizimin e tyre për shkak të punësimit; (vii) menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe shmangien e abuzivitetit.

Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me programin e aftësisë së kufizuar, kanë të bëjnë me: (i) përcaktimin e të drejtës së përfitimit të pagesave të personave me aftësi të kufizuara dhe të së drejtës së përfitimit të një ndihmësi personal; (ii) trajtimin e barabartë të të gjitha grupeve të aftësisë së kufizuar; (iii) heqjen e kufizimit për shkak të punësimit, duke garantuar që ky përfitim të mos ndërpritet në rast punësimi, por ti shërbejë personit me aftësi të kufizuar për tu integruar plotësisht në jetën shoqërore; (iv) thjeshtimin e procedurave të panevojshme për përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar (heqjen e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak), dhe dhënien e këtij përfitimi bazuar në vendimin e autoritetit përgjegjës për përcaktimin e kësaj të drejte.

Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me bonusin e bebeve (mbështetja financiare për foshnjat e porsalindura), kanë të bëjnë me: (i) krijimin e një politike të re sociale pro lindshmërisë; (ii) ofrimin e një ndihme të drejtpërdrejtë ndaj familjeve, për t'i përkrahur pas lindjes së fëmijës; (iii) dhënien e bonuseve të shumëfishuara për fëmijët e lindur.

Efektet e pritshme në tërësi kanë të bëjnë me: Rritjen e eficiencës dhe barazisë në skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, targetimin më të mirë dhe mbulimin më të gjerë të familjeve dhe individëve në nevojë, mosndërprerjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar për shkak të punësimit, rritjen e numrit të lindjeve dhe mbështetjen e familjeve me foshnja të porsalindura. Projektakti garanton administrim, menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të mbrojtjes sociale, shmangien e abuzivitetit dhe menaxhim më të mirë të informacionit nëpërmjet Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni i status quo-së

Në kushtet aktuale, të zbatimit/mospërditësimit të ligjit ekzistues përsa i përket:

I. Ndihmës ekonomike:

- a. Do të vijojë të mbetet problematikë mosmbledhja e Këshillave Bashkiakë dhe për pasojë edhe penalizimi i përfituesve me mosmarrjen e pagesës në kohë.
- b. Do të vijojnë të aplikohen procedura të panevojshme të cilat pengojnë realizimin e detyrave të tjera.
- c. Do të vijojnë refuzimet e përfshirjes në programe nxitje punësimi dhe formimit profesional me qëllim përfitimin nga skema e ndihmës ekonomike.
- ç. Do të vijojë të ekzistojë punësimi informal i anëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike të cilët janë në moshë aktive pune.

d. Do të vijnë të detyrohen të paraqiten çdo muaj pranë zyrtarëve të punës për të kërkuar punë, studentët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, pasi në rast të kundërt penalizohet familja me përjashtim nga skema.

II. Aftësisë së kufizuar:

a. Do të vijojmë të kemi një proces vlerësimit të gjatë e të komplikuar, i cili është i ndryshëm për aftësi të kufizuara të ndryshme, i komplikuar për kërkuesin e përfitimeve dhe jo eficient, i vështirë për t'u menaxhuar nga pikëpamja administrative, dhe i kushtueshëm.

b. Do të ketë mungesë njëtrajtshmërie në funksionimin e komisioneve mjekësore, përse i përket praktikave të vlerësimit dhe njohjes e përcaktimit të aftësisë së kufizuar.

c. Do të vijnë të ekzistojnë raste flagrante të konfliktit të interesit, kur të njëjtët mjekë janë ata që referojnë individin për komisionim dhe që kryejnë vlerësimin për aftësisë së kufizuar të tij/saj si anëtar Komisioni.

ç. Do të vijojë të kryhet vlerësimi me mbingarkesë pune, ku në një ditë mund të vlerësohen 150-200 dosje përfituesish.

Opsioni 1:

Miratimi i një ligji të ri . Krijimi dhe miratimi i një ligji të ri vjen si rezultat i të qenurit në kushtet kur shumica e bazave të krijuara/të parashikuara aktualisht me ligjin bazë nuk përshtaten me nevojat dhe aktualitetin e për rrjedhim ligji aktual propozohet të shfuqizohet.

I. Ndihma ekonomike Jepet një zgjidhje më e mirë në drejtim të thjeshtimit të procedurave të panevojshme për përfitimin e ndihmës ekonomike, duke përcaktuar procese të qarta dhe eficiente të aktorëve të përfshirë në administrimin e skemës. Shmanget abuziviteti në skemën e ndihmës ekonomike duke nxitur qytetarët të përfshihen në programe formimi profesional për të marrë një profesion, përfshirjen në programe këshillimi për punësim, si edhe punësimin e tyre përmes ofertave të punës që disponojnë zyrat e punës.

II. Aftësia e kufizuar Krijohet një sistem i saktë vlerësimi për personat me aftësi të kufizuara sipas modelit biopsiko-social, që shmang abuzimin dhe korrupsionin dhe drejton përfitimet sipas shkallës së nevojave duke inkurajuar gjithëpërfshirjen sociale.

Opsioni 2: Shtesa dhe Ndryshim i ligjit ekzistues

Aktualisht është në zbatim Ligji nr 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar. Ligji që nga viti 2005 deri në vitin 2016 është ndryshuar shtatë herë Janë shtuar nene dhe janë ndryshuar nenet ekzistuese. Ndryshimet aktuale që propozohen përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ligjit ekzistues. Gjithashtu dhe emërtimi i ligjit duhet ndryshuar pasi shërbimet shoqërore janë përcaktuar në Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”..

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.

• *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuar.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuar krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet e prekura janë familjet dhe grupet e rrezikuara, ato më vulnerabël të shoqërisë të tilla si: familjet me kryefamiljare gra; familjet në rrezik përjashtimi, përfshirë romët; fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara; fëmijët dhe gratë e prekura nga dhuna në familje; të papunët afatgjatë; familjet e varfëra me fëmijë e të moshuar në përbërje, jetimët dhe fëmijët pa kujdes prindëror, si edhe viktimat e trafikimit.

Ndikimi i drejtpërdrejtë i politikës do të jetë për familjet e varfëra nëpërmjet zbutjes dhe lehtësimit të varfërisë, duke siguruar pagesa për ata që janë në nevojë dhe për atë që sa të jetë e mundur, mbështetjen e njerëzve për të dalë nga varfëria duke siguruar terrenin për të gjetur mundësitë e riintegrit social dhe ekonomik.

Kjo politikë do të synojë të sigurojë asistencë afat-shkurtër për personat në nevojë, ndërkohë që do t'i inkurajojë dhe mbështesë ata për daljen nga skema duke u punësuar etj., por edhe duke pranuar se një përqindje e aplikantëve do të kërkojnë mbështetje afat-gjatë. Kjo do të arrihet përmes transformimit të skemës së Ndihmës Ekonomike, në mënyrë që të shenjëstrohen vetëm familjet e prekura nga varfëria dhe për t'i mbështetur ato më mirë, për t'u përballur me rreziqet duke hyrë në masat mbrojtëse sociale dhe mundësi më të mira jetese.

Ndikimi i drejtpërdrejtë për reformimin progresiv të sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të jetë përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, ku çdo fëmijë dhe /ose i rritur me aftësi të kufizuara në mënyrë progresive do të kenë qasje dhe do të përfitojnë nga pagesat dhe shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, të formimit profesional dhe punësimit, të një cilësie më të lartë dhe të integruara përmes skemave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale.

Disa nga risqet kanë të bëjnë me: (i) nevojën për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në këtë proces lidhur me legjislacionin e ri dhe sistemin elektronik, (ii) periudhën tranzitore për hartimin e akteve nënligjore dhe reflektimin e ndryshimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar; (iii) pakënaqësia e familjeve aplikuese dhe përfituese për shkak të forcimit të penalteteve për refuzimin e punësimit apo ndërprerjen pa shkaqe të arsyeshme të marrëdhënieve të punës.

Megjithatë, nga ana tjetër do të ketë edhe efekte pozitive lidhur me: nxitjen e punësimit; shmangien e sigurimit të të ardhurave në mënyrë alternative (informale); shmangien e punës informale; mospenalizimin e familjeve me fëmijë në moshë aktive pune që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë; dhe integrimin e familjeve në nevojë në jetën shoqërore.

Ky opsion do të sigurojë rritjen e eficiencës dhe barazisë në skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, targetimin më të mirë dhe mbulimin më të gjerë të familjeve dhe individëve në nevojë, rritjen e numrit të lindjeve dhe mbështetjen e familjeve me foshnja të porsalindura. Po ashtu, garantohet administrim, menaxhim dhe kontroll më i mirë mbi përdorimin e fondeve të asistencës sociale, shmangien e abuzivitetit dhe menaxhim më të mirë të informacionit nëpërmjet përdorimit të Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit.

Krijimi i procesit të ri për përcaktimin e aftësisë së kufizuar do të zbatojë një metodologji bio-psiko-sociale për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar; do të krijojë një proces të përshtatshëm për çdo moshë; do të krijojë një proces transparent dhe të besueshëm dhe një proces me kosto efektive.

Reformimi i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimit sipas "Modelit Social" do të ulë rastet e abuzitit në skemën e aftësisë së kufizuar.

Kjo do të sjellë njëkohësisht rritje të transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar dhe ndërveprimin me një sistem shërbimesh integruar që kombinon shërbimet me pagesat në Cash, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuara. Sigurohet që pagesat në para të jenë të integruara me ofrimin e shërbimeve të kujdesit social, për të garantuar që nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara të jenë përmbushur në mënyrë të plotë dhe të integruar.

Kjo reformë ndikon në krijimin e një sistemi vlerësimi që ofron monitorim, nxit përgjegjshmërinë, nxit rritjen e kapaciteteve profesionale dhe realizon marrëdhëniet ndër-institucionale, duke garantuar (a) një sistem koherent të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; dhe (b) një sistem integral të sigurimit të cilësisë dhe inspektimit, me qëllim parandalimin e abuzimeve.

Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës së Ndhmës Ekonomike, si një nga mekanizmat bazë për të zbutur varfërinë nëpërmjet përfshirjes sociale më të gjerë dhe shenjëstrimit më të mirë të familjeve në nevojë dhe me fokus fëmijët, do të sjellë shenjëstrimin dhe mbulimin më të mirë të familjeve të varfra, garantimin e një sistemi të paanshëm dhe transparent, duke ulur subjektivitetin në vendim-marrje, si dhe rritjen e efikasitetit në administrimin e skemës. Mundësohet krijimi i profilit të riskut të përfituesve, për të zbuluar raste të mundshme abuzimi, monitorimi në kohë reale dhe vlerësimi i performancës së skemës.

Krijohen dhe forcohen struktura dhe mekanizma monitorues, vlerësues dhe raportues në të gjitha nivelet. Kjo do të ndihmojë gjithashtu, në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimit të përdorimit të rritjes së kushtëzuar të NE-së, si për vaksiminin dhe ndjekjen e shkollës nga fëmijët me qëllim rritjen e aksesit në arsim dhe shërbime shëndetësore..

Transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë aktive riintegrimi nëpërmjet paketës për krijimin e mundësive për punësim dhe formim profesional, duke rritur përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës rrit efikasitetin në skemën e ndihmës ekonomike dhe e kthen atë nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të riintegritit dhe alternativitetit të tyre me skemat e punësimit, duke krijuar lidhje të qëndrueshme midis skemës së ndihmës ekonomike dhe skemave të arsimit, formimit profesional dhe programeve të nxitjes dhe ndërmjetësimit për punësim me synim fuqizimin dhe aktivizimin e familjes dhe individit.

Përmes një strategjie daljeje nga skema e ndihmës ekonomike të anëtarëve të familjeve në moshë aktive pune, e cila merr në konsideratë se sa pranë janë aplikantët me tregun e punës dhe se si mund të ndërtohen mekanizmat për lidhjen me tregun e punës do të mundësohet orientimi, asistimi dhe përfshirja në tregun e punës.

Ndikimi i politikës sociale për bonusin e bebeve, siguron një ndihmë të menjëhershme financiare në formën e bonusit për nënat me foshnja të porsalindura, përmes pajisjes së saj me çekun për mirëseardhjen në jetë të fëmijës si ndihmë direkte që Qeveria ndërmerr për familjet shqiptare. Çdo fëmijë i parë i një çifti do të marrë kontributin në masën 40 mijë lekë, 80 mijë lekë fëmija i dytë dhe fëmija i tretë e në vijim 120 mijë lekë. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare do të jepet në formën e një ÇEK-u të emetuar në emër të nënës. Çdo bebe që lind në maternitetet e vendit, regjistrohet aty dhe nuk do të jetë e nevojshme për të bërë të gjithë procedurën në gjendjen civile. Nëpunësi i gjendjes civile i atashuar pranë institucioneve të shërbimit spitalor ku kryhet lindja, bën verifikimin *on-line* të statusit të nënës dhe fëmijës për tu përcaktuar më pas masa e ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi).

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Meqënëse programet e pagesës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar janë programe shpenzuese të qeverisë dhe buxheti i përmbahet tavaneve të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për zgjedhjen e opsionit të preferuar është përdorur analiza kosto-efektivitet.

Opsioni i përzgjedhur mundëson adresimin e të gjitha problematikave dhe nevojave për ndërhyrje lidhur me (i) shmangien e vonësive në gjenerimin e vendimit për përfitimin nga skema e ndihmës ekonomike për shkak të mosmbledhjes në kohë të këshillave bashkiak, duke penalizuar qytetarët në nevojë të mos marrin në kohë pagesën e ndihmës ekonomike; dhe (ii) vështirësitë në procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar siç janë mosfunksionimi i komisioneve mjekësore, vlerësimi bazohet vetëm në kriteret mjekësore, mbi ngarkesë pune ku në një ditë mund të vlerësohen mbi 100 dosje.

Grupet e prekura janë qeveria, kategoritë në nevojë, fëmijët e porsalindur.

Ndikimet janë:

- shpenzimet buxhetore (transfera për buxhetet familjare dhe individet) për programet e asistencës sociale
- zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuar

Kostot:

- Opsioni 1 : 22,500,000,000 lekë

- Opsioni 2: 22,500,000,000 lekë

Përfitimet në njësi të efektivitetit:

- Opsioni 1: 65,000 familje përfituese të ndihmës ekonomike, 162,000 persona me aftësi të kufizuar, 30, 000 fëmijë të porsalindur (257 mije total)
- Opsioni 2: 69,000 familje përfituese të ndihmës ekonomike, 166,000 persona me aftësi të kufizuar, 30, 000 fëmijë të porsalindur (265 mije total).

<i>Opsionet</i>	<i>Kostot</i>	<i>Përfitimet</i>	<i>Raporti</i>	<i>Rezultatet</i>
<i>Opsioni 1</i>	22,500,000,000	257,000	87,548.64	87,548 lekë merr një përfitues
<i>Opsioni 2</i>	22,500,000,000	265,000	84,905.66	84,905.66 lekë merr një përfitues

Në këtë rast meqë rezultati është masa e përfitimit që merr një përfitues, do të zgjedhim opsionin që ofron vlerën më të lartë.

Opsioni 1 parashikon numër më të vogël të përfituesve, meqënëse synon dhe targetimin më të mirë dhe ofrimin e mundësive për punësim të anëtarëve të familjeve të varfëra, shmnagien e abuzivitetit. Ky opsion preferohet pasi ofron vlerën më të lartë të masës së përfitimit nga programet e asistencës sociale.

Kostot e këtij programi janë përfitime për qytetarët në nevojë. Ky opsion preferohet sepse me të njëtin buxhet të miratuar, targetohen më mirë familjet në nevojë dhe rritet masa e përfitimit.

Përfitimet që rrejdhin nga ky program nuk janë përfitime në buxhetin e shtetit, por përfitime në buxhetet e familjeve dhe individëve në nevojë. Dhe zëri buxhetor në programin përkatës buxhetor është emërtuar transfertat për buxhetet e familjeve dhe individëve.

Opsioni 1 është opsioni i preferuar, i cili arrin objektivat e politikës për një traqetim më të mirë të familjeve të varfëra dhe zbutjen e varfërisë së tyre, si më poshtë:

- zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë;
- përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara;
- zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social.

Në fushën e mbrojtjes sociale impakti pozitiv parashikohet të jetë:

- rritja e eficiencës dhe barazisë në skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar;
- targetimi më të mirë dhe mbulimin më të gjerë të familjeve dhe individëve në nevojë;
- rritja e numrit të lindjeve dhe mbështetjen e familjeve me foshnja të porsalindura;
- administrim, menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të mbrojtjes sociale, shmangien e abuzivitetit dhe menaxhimin më të mirë të informacionit nëpërmjet SMI-ve.

Projektligji është një hap i rëndësishëm në funksion të realizimit të objektivave kryesore të politikës, ku shteti brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe mjeteve që disponon *synon reformimin e Programit të Mbrojtjes Sociale nëpërmjet transformimit të Ndihmës Ekonomike në një skemë aktive të riintegritit social, rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë kufizuar dhe sigurimit të mbështetjes financiare për nënat me foshnja të porsalindura, përmes:*

- Zbutjes dhe lehtësimit të varfërisë si një prioritet kyç, duke siguruar pagesa për ata që janë në nevojë dhe për aq sa të jetë e mundur, mbështetjen e njerëzve për të dalë nga varfëria duke siguruar terrenin për të gjetur mundësitë e riintegritit social dhe ekonomik. Kështu ajo do të synojë të sigurojë asistencë afat-shkurtër për personat në nevojë, ndërkohë që do t'i inkurajojë dhe mbështesë ata për daljen nga skema duke u punësuar etj., por edhe duke pranuar se një përqindje e aplikantëve do të kërkojnë mbështetje afat-gjatë.
- Rritjes së efikasitetit dhe transparencës në skemën e Ndihmës Ekonomike, si një nga mekanizmat për të zbutur varfërinë nëpërmjet përfshirjes sociale më të gjerë dhe shenjëstrimit më të mirë të familjeve në nevojë dhe me fokus fëmijët. Rritjen e shenjëstrimit dhe mbulimit të familjeve të varfra, krijimin e një sistemi të paanshëm dhe transparent, duke ulur subjektivitetin në vendim-marrje, si dhe rritjen e eficiencës në administrimin e skemës.
- Transformimit të programit të Ndihmës Ekonomike në skemë aktive nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, duke rritur përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës.
- Përmirësimit të cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara përmes krijimit të një procesi të ri për përcaktimin e aftësisë së kufizuar i cili përfshin vlerësimin bio-psiko-social nga ekupe shumëdisiplinore, bazuar në standardet ndërkombëtare të OBSH-së dhe Konventës së OKB-së për të drejtat e PAK të ratifikuar nga shteti shqiptar.

- Rritjes së transparencës në skemë nëpërmjet përdorimit të regjistrit elektronik kombëtar zbatimin e një administrimi më efikas, eficient, efektiv dhe miqësor për përdoruesit dhe sidomos në drejtim të shërbimit ndaj aplikuesit për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar.
- Sigurimit të ndihmës së menjëhershme financiare në formën e bonusit për nënat me foshnja të porsalindura, përmes pajisjes me çekun për mirëseardhjen në jetë si ndihmë direkte për familjet shqiptare

Ky konsiderohet si opsioni i vetëm që arrin objektivat e politikës. Miratimi i një ligji të ri si model zbatimi, vlerësohet si i përshtatshëm, pasi krijimi dhe miratimi i një ligji të ri vjen si rezultat i të qenurit në kushtet kur shumica e bazave të krijuara/të parashikuara aktualisht me ligjin bazë nuk përshtaten me nevojat dhe aktualitetin e për rrjedhim ligji aktual propozohet të shfuqizohet.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përkthyeri masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Shërbimi Social Shtetëror është një institucion buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, i cili ka si mision zbatimin e politikave të ministrit përgjegjës për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shërbimi Social Shtetëror është i organizuar në nivel qendror dhe rajonal (12 Drejtori Rajonale). Shërbimi Social Shtetëror merr vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike në bazë të projektvendimit të përcjellë nga çdo bashki.

Pranë njërive të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e kësaj politike, janë ngritur dhe funksionojnë Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në nivel bashkie dhe zyrtarë të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar në çdo njësi administrative. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet aplikimi për përfitim nga programi i asistencës sociale. Këto njësi janë përgjegjëse për të identifikuar dhe për të bërë vlerësimin social ekonomik të kategorive në nevojë nën juridiksionin e tyre dhe ti orjentojnë drejt programeve sociale. Ata duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi.

Pas miratimit të projektligjit do të hartohen aktet nënligjore në zbatim të tij.

Masat që do të merren gjatë zbatimit do të përfshijnë:

- kontrollat e zbatimit të legjislacionit për pagesat e ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuara, të cilët kryhen nga struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal, sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore. Struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror përgatit raportet gjashtë mujore dhe vjetore të kontrolleve të kryera në nivel rajonal dhe vendor.

Çdo fazë e procesit monitorues e kontrollues është e digjitalizuar, duke nisur që nga planifikimi e deri tek raportet e kontrollit dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dala nga kontrollat e ushtruara;

- bashkëpunimin e vazhdueshëm ndër-institucional, veçanërisht midis Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Bashkive
- kryerjen e analizave dhe vlerësimin e ndikimit të programeve të asistencës sociale

Pengesat e mundshme për zbatimin e projektligjit të ri mund të kenë të bëjnë me (i) nevojat për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në këtë proces lidhur me legjislacionin e ri dhe sistemin elektronik, (ii) periudhën tranzitore për hartimin e akteve nënligjore dhe reflektimin e ndryshimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar; (iii) pakënaqësinë e familjeve aplikuese dhe përfituese për shkak të forcimit të penaliteteve për refuzimin e punësimit apo ndërprerjen pa shkaqe të arsyeshme të marrëdhënieve të punës.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Zbatimi i legjislacionit për asistencën sociale monitorohet nga Shërbimi Social Shtetëror me anë të treguesve të monitorimit dhe të performancës që masin rezultatet e çdo mase/ veprimtarie., të cilët do të gjenerohen nga regjistrat elektronik të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar.

Treguesit e monitorimit dhe të performancës do të përcaktohen në aktin nënligjor përkatës në zbatim të këtij ligji për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar.

Për programin e ndihmës ekonomike treguesit e monitorimit përfshijnë numrin në total të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, familje përfituese por që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuar, familje përfituese që kanë në përbërje rom apo egjiptian, familje përfituese me krye/familjare gra, familje përfituese me fëmijë trenjakë, katërnjakë dhe pesënjakë, përfitues që janë viktimë të dhunës në familje dhe viktimë të trafikimit, përfitues të kategorisë jetim mbi moshën 25 vjeç, numri i fëmijëve të familjeve përfituese që ndjekin arsimin e detyrueshëm, fondi i shpenzuar për pagesat e ndihmës ekonomike në total dhe në nivel rajonal e vendor.

Për programin e pagesave të aftësisë së kufizuar treguesit e monitorimit përfshijnë numrin në total të personave me aftësi të kufizuar e ndarë kjo sipas rajonale dhe në nivel vendor, numrin e personave të ndarë sipas kategorive të verbër, paradhë tetraplegjikë, persona me aftësi të kufizuar mendor dhe fizik, numrin e personave kujdestarë, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të ndarë sipas sëmundshmërisë dhe grupmohës, fondi i shpenzuar për pagesat e aftësisë së kufizuar në total dhe në nivel rajonal dhe vendor.

Përmirësimi i kuadrit statistikor do të mundësojë një vlerësim objektiv për përmbushjen e masave/veprimtarive të parashikuara në projektligj.

Nga regjistri elektronik për përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar, përveç treguesve të mësipërm do të evidentohen dhe rastet abuzive.

Treguesit kryesore të performancës janë zbutja e varfërisë ekstreme dhe raporti i personave me aftësi të kufizuar që komisionohen dhe përfitojnë nga programi i aftësisë së kufizuar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										

Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			